

VENDIM
Nr. 704, datë 4.11.2022

**PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN E PREZENCËS DHE
VIGJILENCËS SË PËRFORCUAR (EVA), DREJTUAR NGA NATO-ja, NË BULLGARI**
(ndryshuar me VKM-në nr. 476, datë 1.8.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin me mision të një toge, të përbërë nga 30 (tridhjetë) ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në operacionin e prezencës dhe vigjilencës së përforcuar (eVA), drejtuar nga NATO-ja, në Bullgari.

2. Misioni i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është kryerja e detyrave në mbështetje të grup-batalionit shumëkombësh për sigurinë e kufirit lindor të Aleancës, në zonën e caktuar të përgjegjësisë.

3. Vendndisja e togës së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është në Novoselo, Bullgari.

4. Kohëzgjatja e këtij misioni është 3 vjet, me sistem rotacioni. Periudha e rotacionit, për çdo togë, është 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë, së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me togën e radhës.

5. Ministria e Mbrojtjes, për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion, përballon shpenzimet, për:

- a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;
- b) akomodim;
- c) ushqim;
- ç) lavanderi;
- d) sigurimin e jetës;
- dh) siguracionin shëndetësor jashtë zonës së operacionit;
- e) mbështetje shëndetësore;
- ë) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;
- f) transport;
- g) transportimin e individëve të shkëputur të misionit për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;
- gj) aktivitete social-kulturore, në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit;
- h) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

6. Transporti i personelit që merr pjesë në misionin në Bullgari, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t'u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, uji, lavanderia, transporti i individëve të shkëputur nga operacioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, përveç rasteve

kur arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy- ose shumëpalëshe, ku pala/palët tjetër/e tjera të marrë/marrin përsipër të përballojë/përballojnë këto shpenzime.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2022.

8. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku